ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS PJETËR BOGDANI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **90900-25-4789-5-5-8**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me paisje të Teknologjisë Informative për nevojat e BKK-së - Ritenderim**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**EGS**
NUI	**810804486**
Adresa	**Prishtine**
Vendi	**Qendra Tregtare**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**045555560**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Faton Mehmeti**
Adresa elektronike	**prokurimi@egs-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**14.07.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me paisje të Teknologjisë Informative për divizionin e Bibliotekës Digjitale[]Furnizim me paisje të Teknologjisë Informative për divizione tjera të BKK-së

•Autoriteti Kontraktues: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

•Nr. i Prokurimit: 90900-25-4789-5-5-8

•Loti: 1 dhe 2

•Lloji i Procedurës: Mini-tender në kuadër të kontratës kornizë

•Objekti i Kontratës: Furnizim me pajisje IT dhe UPS

•Data e njoftimit për dhënie të kontratës: 23.06.2025

•Data e vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 02.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Në përputhje me nenin 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, para paraqitjes së kësaj ankese në OSHP, kemi ndjekur procedurën paraprake të

kontestimit:

Data e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim: 30.06.2025

Data e pranimit të vendimit nga AK për refuzimin e kërkesës: 02.07.2025

Autoriteti Kontraktues: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Lënda: Refuzim i kërkesës për rishqyrtim në lidhje me aktivitetin e prokurimit me numër 90900-25-4789-5-5-8

Kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim me arsyetim të detajuar ligjor dhe teknik. Autoriteti Kontraktues, me vendimin e datës 02.07.2025, ka refuzuar kërkesën tonë duke mos e shqyrtuar në thelb ankesën dhe duke mos trajtuar mospërputhjet evidente të ofertës fituese me dokumentacionin e tenderit.

Bashkëngjitur kësaj ankese është edhe kopja e vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak, në pajtim me kërkesat e nenit 108A të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur një numër dispozitash të Ligjit për Prokurimin Publik dhe akteve nënligjore në fuqi, si në vijim:

Ligji për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042

Neni 59
Neni 65.2
Neni 72
Neni 108/A

Udhëzuesi 001/2023 i ndryshuar me Udhëzuesin 002/2024

Pika 8.2
Pika 8.3
Pika 8.7

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 38

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Objekti i ankesës:

Parashtruesi i ankesës kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe vendimin për shpalljen si fitues të OE "Storm LLC" për Lotin 1. Vlerësimi i ofertave është bërë në kundërshtim me dokumentacionin e tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi. Në këtë mënyrë është cenuar transparenca, barazia në trajtim, dhe është favorizuar padrejtësisht një OE me dokumentacion të papërmbushur teknikisht.

Bazat faktike dhe ligjore të ankesës

I.Oferta jonë ishte në përputhje të plotë me kërkesat teknike

Oferta jonë përfshinte:

- **Pajisjet HP 290 G9 PRO Tower dhe HP P27H G5;**
- **Tabelë teknike të nënshkruar me deklarim për përputhshmëri 100%;**
- **Garanci 3-vjeçare të deklaruar;**
- **Specifikime të modeleve të gjurmueshme në faqet zyrtare të prodhuesit;**
- **Autorizime për HP, DELL dhe LENOVO (të dorëzuara në AQP sipas nenit 65.2 LPP).**

AK nuk kërkoi sqarim sipas nenit 59.2 të LPP-së, përkundër mundësisë që çdo paqartësi të sqarohej. Kjo përbën shkelje të së drejtës sonë për një trajtim të drejtë dhe objektiv të ofertës sonë.

Precedentë të OSHP-së:

- *Vendimi nr. 109/2021:* OSHP konstatoi se mungesa e sqarimit të ofertës përbën shkelje procedurale.
- *Vendimi nr. 355/2023:* Vlerësimi pa kërkesë për sqarim konsiderohet i pabazuar dhe diskriminues ndaj OE-së .

II. Oferta e OE "Storm LLC" është e papërgjegjshme për Lotin 1

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE fitues, rezultojnë këto mospërputhje me specifikimet teknike të kërkuara për UPS:

Specifikimi	Kërkesa	E ofruar nga Storm	Vlerësimi
- Garanci	**3 vite**	**2 vite në broshurë**	**X**
- Forma e valës	**Step wave**	**Nuk specifikohet**	**X**
- Diapazon frekuence	**E kërkuar**	**Nuk figuron**	**X**
- Bateria	**Kapacitet & numër**	**Nuk është i specifikuar**	**X**

AK është mbështetur në një deklaratë të përgjithshme nga prodhuesi, e cila nuk specifikon modelin e ofertuar.

Kjo bie ndesh me:

- Pika 8.3 e Udhëzuesit 002/2024, që përcakton qartë se vlerësimi teknik bëhet vetëm në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me ofertë;
- Neni 7.1 dhe 7.2 i LPP-së, për transparencë dhe trajtim të barabartë.

Precedentë të OSHP-së:

- Vendimi nr. 184/2021: U anulua vendimi i AK-së për pranim të një oferte ku mungonin specifikime teknike.
- Vendimi nr. 276/2022: Oferta u konsiderua e papërgjegjshme për shkak të mungesës së dokumentacionit për modelin konkret të produktit .

III. Vendosja e kritereve të reja – shkelje e rregullësisë së procedurës

AK ka kërkuar autorizim për produktin UPS, ndonëse ky produkt nuk është pjesë e AQP-së. Kjo kërkesë shtesë është vendosur arbitrarisht pas publikimit të ftesës dhe pa bazë ligjore.

Kjo bie ndesh me:

- Pika 8.2 e Udhëzuesit 002/2024, që ndalon qartë vendosjen e kritereve të reja në mini-tendera që nuk janë pjesë e kushteve të paracaktuara në kontratën kornizë;
- Neni 7.3 i LPP-së, për ndalim të diskriminimit dhe modifikimit të kushteve të tenderit pas shpalljes së ftesës.

Precedent i OSHP-së:

- Vendimi nr. 423/2022: U anulua vendimi i AK-së për shkak të vendosjes së kritereve shtesë që nuk ishin pjesë e dokumenteve të tenderit .

Kërkesat tona:

1. Të anulohet vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;
2. Të anulohet shpallja si fitues e OE "Storm LLC" për Lotin 1 dhe Lot 2
3. Të bëhet rivlerësimi i ofertës sonë për Lotin 1 dhe 2, në përputhje me ligjin dhe dokumentet relevante;
4. Të konstatohet se ka pasur shkelje të dispozitave të lartcekura nga ana e AK-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e pretenduara nga Autoriteti Kontraktues na kanë shkaktuar dëme materiale të drejtpërdrejta dhe të matshme në këto forma:

Kosto direkte financiare për përgatitjen e ofertës, përfshirë hartimin e dokumentacionit teknik, sigurimin e autorizimeve, angazhimin e stafit profesional dhe shpenzimet e tjera administrative të lidhura me pjesëmarrjen në procedurë;

Sigurimi i tenderit, i cili është depozituar për të dy lotët dhe mbetet i bllokuar për shkak të eliminimit të paarsyeshëm dhe joligjor;

Shpenzime për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim, përfshirë këtu analizën ligjore dhe teknike të vendimit të AK-së;

Humbja e mundshme e të ardhurave të planifikuara nga realizimi i kontratës, nëse OSHP nuk ndërhyn për të korrigjuar këtë situatë të padrejtë.

Për më tepër, eliminimi i padrejtë cenon integritetin dhe kredibilitetin tonë si operator ekonomik që ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe konkurruese, dhe dërgon sinjale negative për investimin e mëtejmë në procedura të prokurimit publik.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*